



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:012865

Datë: 04.12.2023

Numri i dokumentit: 05010596

P.nr.243/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Dibran Jusufi, me bashkëpunëtoren profesionale Sadete Kuqi Berisha, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.M., për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikeve i substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.nr.5400/19 të datës 24.01.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 23.11.2023, të hapur për publikun, në prani të prokurores së shtetit Zana Sadiku Sertolli dhe të akuzuarit B.M. së bashku me mbrojtësen sipas autorizimit Av. E. M., me datë 24.11.2023 morri dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 04.12.2023 përpiloi me shkrim këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari B.M. nga babai M. dhe nëna B., e gjinisë Z., i lindur me në, ndërsa me vendbanim në lagjen, Rr. “.....”,, i pa martuar, student në kolegjin AAB, i pa punësuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datën 18.10.2019 rreth orës 21:00 në Prishtinë në Rr. “Eqrem Qabej” afër lokaleve tek Lesna, i pandehuri B.M. pa autorizim ka poseduar substancë narkotike në atë mënyrë që gjatë kontrollit rutinor nga Policia e Kosovës, njësia për hetiminin me narkotik të pandehurit në fjalë ju është gjetur një cigare e mbështjellur me bari ngjyrë të gjelbërt e cila sipas raportit të ekspertimit është substancë narkotike e llojit “Kanabis-Mariuhanë” e cila përmbanë Tetrahidrokanabinol (THC) me sasi prej 0.19 gram, sasi e cila është sekuestruar nga zyrtarët policor.

-Me këtë e ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-së,

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4, 38, 39, 42, 43, 46, 47, 48, 49, 69 dhe 70 të KPRK-ës dhe neneve 242 e 364 të KPP-ës, të akuzuarve i cakton:

E GJYKON

I. Me dënim me gjobë me shumën prej 800 € (tetëqind euro) të cilin dënim obligohet ta paguaj në afat prej 30 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

II. Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 2 (dy) vite nuk kryen vepër tjetër penale.

III. Nëse i akuzuari nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

IV. Në bazë të nenit 269 paragrafi 3 i KPRK-ës ndaj të akuzuarit konfiskohet substanca narkotike e llojit “Kanabis - Marihuanë”, me peshë 0.19 gram. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, kjo substancë narkotike duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, në bashkëpunimin me institucionet tjera relevante, sipas procedurave standarde në fuqi.

V. Obligohet i akuzuari e lartcekur të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzet euro) dhe shumën prej 20 (njëzet) euro për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm.

A R S Y E T I M

-Rrjedha e procedurës penale-

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me datë 30.01.2020, pranë kësaj gjykate, ka paraqitur aktakuzën me numër PP/II.nr.5400/19 të datës 24.01.2020, kundër të akuzuarit B.M. dhe M.R. për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikeve i substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së.

Me datë 23.11.2023, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ish-in prezent prokurorja e shtetit Zana Sadiku Sertolli dhe i akuzuari B.M. me mbrojtësen e tij

sipas autorizimit Av. E. M., ndërsa me aktvendim është veçuar lënda për të pandehurin M. R. e cila do të procedohet ndaras.

Në këtë seancë prokurorja e shtetit ka lexuar aktakuzën lëndore, me ç'rast i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë me ç'rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 242 të KPRK-ës, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të akuzuarit

-Vlerësimi i pranimit të fajësisë-

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezentë palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të akuzuarit B.M. për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 242 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezentë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i akuzuari e kanë kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, se i akuzuari nuk kanë qenë i detyruar ose të shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza, e po ashtu me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmbajnë asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

-Gjendja faktike e vërtetuar-

Gjykata nga të lartcekurat ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor për veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që gjeti se i njëjti është penalisht përgjegjës dhe se nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të të akuzuarit dhe se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të kësaj vepre penale.

-Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit-

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të akuzuarit ti shqiptohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesëve dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit

në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës, gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese për të akuzuarin ka marrë parasysh faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale, se i njëjti është penduar, i vjen keq për rastin, dhe se ka premtuar se nuk do të përsërisë më veprimet të tilla, ndërsa si rrethana rënduese gjykata ka marrë parasysh se për të njëjtin nuk është hera e parë që bie ndesh me ligjin dhe është i dënuar me aktgjykim të formës së prerë sipas aktgjykimit PKR.298/2021. Duke u bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit mund të arrihet qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

-Vendimi lidhur me konfiskim-

Gjykata duke u bazuar në dispozitën e nenit 276 par. 1 dhe 2 të KPP-së, si dhe nenit 269 par. 3 të KPRK-së ka urdhëruar konfiskimin e detyrueshëm dhe të përhershëm të substancës narkotike të llojit “Kanabis-Marihuanë”, me peshë prej 0.19 gram, e sekuestruar nga i pandehuri. Gjykata, ka vërtetuar se i pandehuri nuk posedonte leje, e as autorizim për posedimin e narkotikëve, për më tepër, substanca narkotike e lartcekur bënë pjesë në sendet që konfiskohen në mënyra automatike, andaj gjykata ka vendosur të konfiskoj përherë këtë sasi të narkotikëve, si dhe ka urdhëruar shkatërrimin e saj, pasi që ekziston baza ligjore për konfiskimin e përhershëm të substancës narkotike, ashtu siç përcaktohet me nenin 276 të KPP-së dhe nenin 269 par.3 të KPRK-së, që rregullon konfiskimin e detyrueshëm.

-Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale-

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par.2 pika 2.6 të KPPRK-së. Ndërsa, për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr komfor nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.243/20, me datë 04.12.2023

Gjyqtari i vetëm gjykues
Dibran Jusufi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.